

Vendim nr. 121 datë 03.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare

në datën 03.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARJAN SARAÇI**, përfaqësuar nga avokat Emin Saraçi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3606, datë 14.09.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 16, pika 2, 18, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 71, 71/a dhe 81, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Arjan Saraçi, me vendimin e datës 28.02.2013 të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve (*punëdhënësi*) është emëruar përkohësisht në detyrën e inspektorit të dytë në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor deri në përfundimin e procedurave të konkurrimit për këtë pozicion pune. Ai nuk është kualifikuar në fazën e konkurrimit me shkrim, ndaj, në datën 25.02.2014, punëdhënësi ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me efekte të menjëhershme financiare, bazuar në legjislacionin për administratën tatimore dhe statusin e nëpunësit civil të vitit 1999. Vendimi i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës i është komunikuar kërkuesit në datën 10.03.2014.

2. Me pretendimin se vendimi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës ishte absolutisht i pavlefshëm, pasi kishte dalë mbi bazën e një ligji të shfuqizuar dhe në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë, duke kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, si dhe pagimin e pagës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 5838 (5888), datë 22.10.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ishte i pabazuar në ligj pretendimi i kërkuesit se ai kishte fituar statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013. Sipas saj, kërkuesi ka paraqitur padi pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 5, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me të cilin ishte shfuqizuar akti normativ me fuqinë e ligjit, i nxjerrë nga Këshilli i Ministrave për zgjatjen e afatit të hyrjes në fuqi të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Në rastin konkret, sipas gjykatës së shkallës së parë, vendimi i Gjykatës nuk ka efekte prapavepruese, pasi padia duhet të ishte paraqitur para datës 26.02.2014.

4. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 4106, datë 24.11.2016, me arsyetimin se hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 në datën 01.10.2013 nuk i kishte dhënë atij automatikisht statusin e nëpunësit civil. Për këtë arsye, sipas gjykatës së apelit, mosmarrëveshja zgjidhej sipas dispozitave të Kodit të Punës, të cilat ishin të zbatueshme deri në momentin e largimit të kërkuesit nga puna. Gjykata e apelit ka vlerësuar se në momentin e lidhjes së kontratës kërkuesi ka qenë i vetëdijshëm për punësimin e tij në një pozicion pune që i takonte një nëpunësi tjetër civil, statusin e të cilit ai nuk e gëzonte, ndaj vendimi i punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës nuk i tejkalonte pritshmëritë e tij, për sa kohë që me pranimin e këtij pozicioni pune ai kishte rënë dakord të ofronte shërbimin e tij, deri në momentin e përfundimit të procedurave të konkurrimit.

5. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3606, datë 14.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk ngrinte ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative

dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka sqaruar plotësisht faktet e mosmarrëveshjes, i ka cilësuar juridikisht saktë ato dhe ka vlerësuar tërësisht dhe objektivisht provat, duke u dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuarit, të cilat janë ngritur nga ai edhe në rekurs. Ndërsa për sa u takon provave, vlerësimi i tyre del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, ndaj pretendimi për rihapjen e shqyrtimit gjyqësor është i papranueshëm.

6. Në datën 20.02.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim, sipas objektit, i cili pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 03.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

- 7.1. *E drejta për t’u dëgjuar*, pasi rrëzimi i padisë i ka kufizuar të drejtën për kërkuar në gjykatë dëmshpërblim nga veprimet e paligjshme të punëmarrësit për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Megjithatë vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, mosmarrëveshja nuk është zgjidhur. Ajo gjykatë duhej të bënte dallimin ndërmjet kërimit të tij për pavlefshmërinë e aktit administrativ mbështetur në një ligj të shfuqizuar dhe cilësimit të bazës ligjore të marrëdhënies së punës mbështetur në Kodin e Punës.
- 7.2. *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi është alogjik në raport me provat dhe ligjin, si dhe me qëndrimin që kanë mbajtur gjykatat më të ulëta ndaj ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Pretendimet e ngritura në rekurs nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor, ndërsa arsyetimi i Gjykatës së Lartë është sipërfaqësor, aspak bindës, kontradiktore dhe i turbullt. Në të kundërt të asaj që argumenton Gjykata e Lartë, gjykata e apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se marrëdhënia e punës është zgjidhur bazuar në një ligj të shfuqizuar dhe se kërkuari e ka fituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit.
- 7.3. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar me standard të dyfishtë në raport me vendimin unifikues të saj nr. 3, datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë

(vendimi unifikues nr. 3/2012), ndërkohë që ai ka pretenduar zbatimin e keq të ligjit, për shkak se vendimi për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës është bazuar në një ligj të shfuqizuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Lartë Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e njoftimit elektronik të tij, në rast se

palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 14.09.2023 dhe i është njoftuar me postë elektronike kërkuesit në datën 20.10.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është dërguar në Gjykatë në datën 20.02.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

14. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike, të garantuara nga nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se thelbi i argumenteve të tij lidhet me mënyrën se si gjykatat kanë arsyetuar vendimmarrjen e tyre, çmon t'i analizojë pretendimet në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, i cili *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

15. Gjykata ka theksuar se arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Ai, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Me arsytimin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, sipas Gjykatës, vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, e cila nuk cenon standardet kushtetuese, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjatë kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo standardet kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 18, datë 15.03.2016; nr. 8, datë 28.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik, sipërfaqësor, aspak bindës, kontradiktor dhe i turbullt. Sipas kërkuesit, gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për pretendimet e tij se vendimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës është bazuar

në ligj të shfuqizuar dhe se kërkuesi ka fituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit, ndaj vendimi i Gjykatës së Lartë është i pasaktë kur shprehet se kërkuesi ka marrë përgjigje shteruese nga gjykata e apelit. Po kështu, sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë, në zbatim të vendimit unifikues nr. 3/2012, duhej të bënte dallimin që ekzistonte midis kërkimit për pavlefshmërinë e vendimit për zgjidhjen e marrëdhënies së punës bazuar në një ligj të shfuqizuar dhe cilësimit ligjor të mosmarrëveshjes mbështetur në Kodin e Punës. Si pasojë e rrëzimit të padisë, shprehet kërkuesi, atij i është kufizuar e drejta për të kërkuar dëmshpërblim në gjykatë.

18. Kolegji vëren se, në të kundërt me sa pretendon kërkuesi, gjykatat e faktit u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij, duke arsyetuar se ai nuk e ka fituar statusin e nëpunësit civil, sepse nuk e ka përfunduar me sukses procedurën e nevojshme për fitimin e këtij statusi, për shkak të moskualifikimit në testimin me shkrim, për rrjedhojë në rastin e tij aplikohen dispozitat e Kodit të Punës. Ato kanë vlerësuar se marrëdhënia e punës së kërkuesit ka përfunduar në datën 25.02.2014, ndërsa padia është paraqitur në gjykatë pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 5, datë 05.02.2014, ndaj ky i fundit nuk ka efekt prapaveprues në rastin e tij. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi ka qenë i vetëdijshëm për punësimin e tij në një pozicion që i takonte një nëpunësi civil, status të cilit ai nuk e gëzonte dhe shkak i ndalimit të ushtrimit të detyrës pas përfundimit të procedurave të konkurrimit reflekton vërtetimin e kushtit zgjidhës të kontratës së punës me të cilin ai më herët kishte rënë dakord. Kurse rekursi i kërkuesit nuk është pranuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se gjykata e apelit ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të, si dhe një analizë tërësore dhe objektive të provave, duke bërë që edhe shkaqet e parashtuara në rekurs të kenë marrë përgjigje shteruese.

19. Në këto rrethana, Kolegji evidenton se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit nuk përmban pasaktësi, në pjesën që shprehet se kërkuesi ka marrë përgjigje shteruese për pretendimet e tij. Nuk rezulton që ai të jetë alogjik, i parregullt në formë ose i paqartë në përmbajtje. Gjithashtu, duke pasur parasysh që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, arsyetimi i kufizuar i vendimit nuk ka cenuar standardet kushtetuese, përderisa në thelb ka treguar shkaqet, për të cilat rekursi i kërkuesit nuk është pranuar. Po kështu, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë, brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, ka arritur në përfundimin se gjykatat e faktit kanë identifikuar drejt ligjin e zbatueshëm dhe kanë interpretuar saktë konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të bazës ligjore të padisë dhe së drejtës së gjykatës së zakonshme për të bërë me nismën e saj cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që i paraqitet për shqyrtim. Kolegji rithekson se interpretimi i ligjit gjatë

zgjdhjes së mosmarrëveshjeve është detyrë kushtetuese e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj pretendimi i kërkuarit nuk është i pranueshëm në këndvështrim të kriterit *ratione materiae*.

20. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara, ndaj kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.